



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.263/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Selajdin Bytyçi, kandidat i pavarur për Kryetar të Komunës së Malishevës, paraqitur kundër Albert Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Malishevë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet si e pas afatshme ankesa e Selajdin Bytyçi, kandidat i pavarur për Kryetar të Komunës së Malishevës, paraqitur kundër Albert Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Malishevë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë: ZLA.nr 263/2017 nga Selajdin Bytyçi, kandidat i pavarur për Kryetar të Komunës së Malishevës, me të cilat pretendon se ka vërejtur që billbordin e tij e ka dëmtuar Albert Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Malishevë. Parashtruesi i ankesës thekson se rastin e ka paraqitur edhe në Stacionin Policor të Malishevës, me datë 16-17.10.2017.

Paneli pas shqyrtimit dhe hetimit të të gjitha dëshmive relevante gjeti se:

Ankesat janë të pasafatshme.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Selajdin Bytyçi, kandidat i pavarur për Kryetar të Komunës së Malishevës, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 5.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ku përcaktohet: “Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtë për drejtë me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”. Ngase prej shkresave të lëndës del se shkelja e pretenduar nga Albert Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Malishevë, është bërë me 216/17.10.2017. Afati për ankesë ka qenë 24 orë nga

shkelja e supozuar. Ankesa në PZAP nga Selajdin Bytyçi, kandidat i pavarur për Kryetar të Komunës së Malishevës, është paraqitur me datë 20.10.2017, çka do të thotë se 4 (katër) ditë pas afatit të përcaktuar në dispozitën e nenit 5.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së dhe nenin 5 par.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr. 263/2017 më datën 20.10.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.